



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 05, datë 10.11.2017

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“GODINË POLIFUNKSIONALE 2, 4, 16 DHE 24 KATE “GARDEN BUILDING”,
ME VENDNDODHJE NË RRUGËN E KAVAJËS, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Tirana 1 Konstruksion” sh.p.k dhe shoqërisë “Nova Construction 2012” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë polifunksionale 2, 4, 16 dhe 24 kate “Garden Building”, me vendndodhje në Rrugën e Kavajës, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Tirana 1 Konstruksion” sh.p.k dhe shoqërinë “Nova Construction 2012” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

